

Cili është ndikimi i partive politike në konsolidimin demokratik?

Mërgim Berishaj

Prishtinë, 15-08-2013

I. Hyrje

Në këtë punim synoj të analizoj ndikimin e partive politike në konsolidimin e demokracisë në një shoqëri. Ky studim do të bëhet me metodën kualitative hulumtuese duke studiuar literaturën përkatëse për këtë temë. Arsyeja që e kam zgjedhur këtë temë për hulumtim është sepse në Kosovë jemi në fazën e tranzicionit nga një sistem autoritar tek një sistem demokratik, por ne jemi duke hasur shumë vështirësi pasi që rruga drejt konsolidimit demokratik është e mjegullt dhe me shumë pasiguri. Ekzistojnë shumë faktorë të cilët e ndihmojnë ose e vështirësojnë procesin e konsolidimit, dhe një nga këta faktorë janë partitë politike. Prandaj ky studim ka si qëllim të paraqet ndikimin e partive politike në konsolidim dhe fushat në të cilat ato ndikojnë.

Në vazhdim do të analizoj termin e tranzicionit demokratik, të konsolidimit demokratik, partitë politike si term i përgjithshëm dhe ndikimin e tyre në procesin e konsolidimit demokratik. Duke u nisur prej faktit që partitë politike janë ato që i drejtojnë shoqëritë në tranzicion drejt konsolidimit të demokracisë, në këtë punim ato do të kenë rolin qëndror të analizës. Kualiteti i një demokracie liberale varet shumë nga bindja e grupeve të ndryshme në rregullat demokratike dhe këtë e shtjellon R. Hague dhe M. Harrop. Sipas tyre gara e partive politike është garanci më i madh i demokracisë liberale, pasi që është ajo që i bënë partitë të kenë përgjegjësi ndaj votuesve.¹

II. Tranzicioni Demokratik

Tranzicion demokratik quhet pika e shuarjes së një regjimi autoritar dhe fillimi i proceseve demokratike. Fillimi i tranzicionit karakterizohet me një shpërbërje të regjimit autoritar i cili fillon me shenjat e para të mobilizimit të masave dhe përfundon me vendosjen e një forme të re të qeverisjes e cila fiton legjitimitet nëpërmjet zgjedhjeve. Autori Dankwart Alexander Rustow i dallon tri faza të tranzicionit:

1. Faza e përgatitjes që arritët me polarizimin e aktorëve kryesorë politik.
2. Faza e vendimit ku institucionalizohen elementet kryesore të procedurës demokratike.

¹ Hague Rod & Harrop Martin, *Comperative Government and Politics (Krahasim Qeveritar dhe Politik)*, 6th Edition, Basingstoke, Macmillan, 1987, Fq. 141-142

3. Faza e tranzicionit që është periudha gjate së cilës politikanët dhe elektorati janë mësuar me rregullat e reja politike.²

Ajo e cila e bënë Rustow-in të njohur është se ai e kundërshton idenë se duhen parakushte sociale dhe ekonomike për të arritur demokracinë dhe thotë se ajo që nevojitet është uniteti nacional si parakusht për demokracinë dhe arritja e një konsensusi të elitave politike. Autori i studion rastet e Turqisë dhe Suedisë dhe i përcakton katër faza të cilat i kalojnë shtetet gjatë demokratizimit.

1. Uniteti Nacional (National Unity) Formimi i një sensi të pakontestuar të vetëdijes kombëtare, ajo që më vonë quhet Stateness si parakusht i domosdoshëm.³
2. Një luftë e zgjatur dhe jobindëse politike kjo ndodh në mënyra të ndryshme në të gjitha shtetet, por është e përqendruar përreth një fuqizimi të një force sociale të re. Demokracia lind brenda këtij konflikti. Ky konflikt mund të jetë aq i ashpër sa që mund të rezultojë me fitoren e njërit grup ndaj tjetrit dhe ti mbylle duart demokratizimit.⁴
3. Faza e vendimit (Decision Phase) kur grupet në konflikt e kuptojnë se rruga e tyre dhe lufta politike është jobindëse dhe ata vendosin të negociojnë dhe të adoptojnë forma demokratike të qeverisjes.⁵
4. Faza e përshtatjes (habituation Phase) progresivisht rregullat e demokracisë bëhen të zakonshme.⁶

Për të kuptuar termin tranzicionin demokratik është e domosdoshme ti referohemi edhe veprës së mendimtarëve të kësaj fushe Juan Linz dhe Alfred Stepan. Këta dy autorë shkojnë një hap më larg dhe kërkojnë të kuptojnë se si karakteri i regjimeve të ndryshme jodemokratike ndikojnë ose nuk ndikojnë në kompletimin e tranzicionit demokratik. Pra sipas tyre një tranzicion demokratik është i kompletuar kur kemi:

- 1) Një marrëveshje të mjaftueshme për të prodhuar një qeveri të zgjedhur.
- 2) Kur një qeveri vjen në pushtet si rezultat i votës së lirë dhe demokratike
- 3) Kur kjo qeveri, de facto, ka autoritet për të zhvilluar politika
- 4) Kur pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor të gjeneruar nga demokracia e re nuk kanë nevojë ta ndajnë pushtetin me institucione tjera de jure.⁷

Pra me këtë definicion mund ta bëjnë dallimin ndërmjet liberalizimit dhe demokratizimit. Liberalizimi i një sistemi jo-demokratik nënkupton ndryshime politike dhe sociale si për

² Rustow Dankward, *Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model (Tranzicionet Demokratike Drejte një Modeli Dinamik)*, Columbia University Press, 1970, Fq 338

³ Ibid, Fq 350

⁴ Ibid, Fq 338

⁵ Ibid, Fq 380

⁶ Ibid, Fq 380

⁷ Linz Juan & Stepan, Alfred, *Democratic Transitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe (Tranzicionet Demokratike dhe Konsolidimi Demokratik: Europen Jugore, Ameriken Jugore dhe Shtetet Post-Komuniste)*, Mimeo, 1991, Fq 6

shembull më pak censurë ndaj mediave, lirimin e të burgosurve politik etj. Ndërsa me termin demokratizim nënkuptojmë kontestimin e hapur mbi të drejtën për të kontrolluar qeverinë dhe nënkupton zgjedhjet e lira dhe demokratike të cilat determinojnë se kush qeverisë.

III. Konsolidimi Demokratik

Krahasuar me tranzicionin e regjimeve, konsolidimi është një koncept shumë më i mjegullt me më shumë pasiguri të konsiderueshme rreth pikave përfundimtare. Në çdo rast koncepti i konsolidimit konsiderohet si proces më i gjerë, më i thellë dhe më i gjatë sesa tranzicioni. Këtu së pari do ta analizoj pikëpamjen e Laurence Whitehead i cili i përmbledh shumë mirë karakteristikat e procesit të konsolidimit demokratik dhe rolin ekskluziv të elitave politike në këtë proces duke e theksuar lidhjen ndërmjet sistemit dhe shoqërisë.

Sipas Whitehead ideja e konsolidimit mund vetëm të sqarohet në kontrast me nocionin e tranzicionit që e paraprinë atë. Pas çdo tranzicioni nga sundimi autoritar demokracia emergjente do të jetë një regjim, në të cilën jo të gjithë aktorët politike nuk kanë kredenciale të mjaftueshme demokratike, edhe ku rregullat demokratike të procedurës ende janë duke u përvetësuar nga shoqëria në përgjithësi. Nëse faza e tranzicionit nuk është ndërprerë, ajo mund të hapë rrugën për një proces të konsolidimit demokratik. Pika referuese e këtij procesi do të jetë pasiguria e periudhës së tranzicionit progresivisht zvogëlohen pasi që procedurat e reja kuptohen më mirë, dhe pranohen më gjerësisht. Regjimi i ri bëhet i institucionalizuar, korniza e hapur dhe shprehja konkurruese politike bëhet e internalizuar, kështu në masë të madhe paqartësitë dhe rreziqet tejkalohen. Ky proces mund të kompletohet në periudhën kohore të një gjenerate. Kur procesi i demokratizimit avancohet nga fundi i tranzicionit tek konsolidimi i plotë ka një zgjerim të aktorëve politik të cilët adoptojnë sjelljen demokratike, një thellim i angazhimit të aktorëve të cilët negociojnë kornizat demokratike (pra të gjithë marrin një qëndrim parimor në vend të qasjes instrumentale ndaj respektimit të këtyre kornizave). Në këtë mënyre aktorët politikë mësojnë se si të ndryshojnë perceptimet e vetvetes, të tjerëve apo tërë sistemit. E tërë kjo arrihet me një kampanjë të koordinuar ose faktikisht të organizuar për ta familjarizuar masën me pranimin e rregullave demokratike.⁸

Sipas Linz-it dhe Stepan-it demokracinë e konsoliduar e definojnë si një dimension sjellje, qëndrimi dhe kushtetutë pra me fjalë të tjera konsolidimi arrihet vetëm kur demokracia është bërë e vetmja lojë në qytet. Në aspektin e sjelljes (Behaviourally) një regjim demokratik në një shoqëri është i konsoliduar kur asnjë aktor nacional, social, ekonomik, politik ose institucional nuk shpenzon burime të rëndësishme për t'i përmbushur objektivat e veta jo-demokratike. Në aspektin e qëndrimit (attitudinally) një regjim demokratik është i konsoliduar kur shumica absolute e opinionit publik beson se institucionet dhe procedurat demokratike janë mënyra më e

⁸ Whitehead Laurence, *The Consolidation of Fragile Democracies (Konsolidimi i Demokracive të Brishta)*, European Consortium for Political Research (ECPR), 1988, Fq 6-8

përshtatshme për të qeverisur jetën kolektive në një shoqëri si ajo e tyre dhe kur përkrahja e alternativave anti-sistem është e vogël ose pak a shumë e izoluar në raportin me forcat pro demokratike. Në aspektin kushtetues (Constitutionally) një regjim demokratik është i konsoliduar kur edhe forcat qeveritare dhe ato opozitare zgjedhjen e konflikteve e bëjnë përmjet ligjeve dhe procedurave demokratike.⁹

IV. Partitë politike dhe ndikimi i tyre në konsolidimin demokratik

Siç e ka argumentuar Bingham Powell një sistem i fortë i partive politike është thelbësor për një demokraci të fortë. Forma e sistemit partiak influencon pjesëmarrjen e qytetarëve në garat elektorale. Stabiliteti i udhëheqjes varët nga veprat e partisë në arenat elektorale dhe legjislative. Dinamika e sistemit partiak mundet ose ta pengojë ose të ndezë trazirat dhe dhunën. Strategjitë dhe angazhimet e liderëve të partive mund të jenë kritike për mbështetjen e regjimit demokratik në kohën e krizës.¹⁰

Sipas Leonardo Morlino konsolidimi nëpërmjet partive është karakterizuar mbi të gjitha nga një organizim progresiv dhe zgjerim i strukturave të partisë dhe sistemit partiak në përgjithësi, e cila pastaj është në gjendje të kontrollojë dhe nëse është e nevojshme të modeloj dhe integrojë të gjitha format e pjesëmarrjes.¹¹ Kështu që autori përmbledh rëndësinë e partive politike. Jo vetëm siç ai argumenton në institucionalizimin e regjimit të ri po gjithashtu krijon hapësirë për zhvillimin e participimit dhe në rrënjosjen e sistemit të ri në shoqëri. Në fushëveprimin aktual për palët në procesin e konsolidimit cek se një sistem parlamentar mund të jetë i favorshëm në fillim, me penetrimin nga grupe të strukturave vendimmarrëse të ndryshme, por kjo tendencë mund të tejkalohet nga faktorët të tjerë, nga numri i partive, lloji i sistemit partiak dhe nga marrëdhënia ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit.¹²

Në sferën e rëndësisë së zhvillimit të partive dhe në ndikimin e ndryshimeve sociale dhe politike, duhet të shtjellojmë rolin e partive në procesin e konsolidimit. Pasi që partitë së bashku më aktorët e rëndësishëm politik janë makineri e zhvillimit të demokracive. Sipas Rustow-it faza e përshtatjes e regjimit nën tranzicion përfshi një proces të dyfishtë të selektivitetit darvinian në favor të demokratëve të bindur. Rustow sheh tre elemente të cilët e theksojnë rolin e partive në mënyra të ndryshme. Politikanët dhe qytetarët mësojnë nga zgjedhjet e suksesshme të disa çështjeve për të vendosur besimin e tyre në rregullat e reja dhe për ti përdorur ato për çështje të reja. Përvojat me teknikat demokratike dhe rekrutimin konkurrues konfirmon politikanët në

⁹ Linz, Juan & Stepan, Alfred, *Democratic Transitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe*, Mimeo, 1991, Fq 6

¹⁰ Bingham Powell, *Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence (Demokraci Bashkëkohore: Stabilitet dhe Dhunë)*, Cambridge, Mass., Harvard University Press, 1982, Fq. 7

¹¹ Morlino, Leonardo, *Democratic Consolidation (Konsolidimi Demokratik)*, Oxford University Press, 1998, Fq. 25

¹² Ibid, Fq 26

praktikat dhe bindjet e tyre demokratike. Popullsia hynë në strukturën e reja duke u lidhur efektivisht me organizimin partiak.¹³

Ndërsa kontributi i partive politike dhe të elitave politike në funksionimin e regjimit demokratik është i madh, sepse këto kanë penguar shfaqjen e alternativave të tjera siç janë sundimi ushtarak, politika burokratike, dominimin e lobit dhe kështu me radhë. Pra duhemi të jemi të vetëdijshëm për rolin e luajtur nga partitë politike dhe elitave e partiake në tranzicionin nga regjimet autoritare në konsolidimin e demokracisë. Liderët partiak kanë ofruar zgjidhjen viabile.¹⁴

V. Konkluzionet

Pra duke analizuar faktin se partitë politike përbëjnë elementin thelbësor të konsolidimit demokratik në shoqëritë moderne. Të dala nga vetë shoqëria, në shumicën e demokracive partitë politike luajnë rolin e ndërmjetësit mes qytetarëve dhe organeve kushtetuese. Në shumicën e rasteve ato hyjnë madje edhe në sferën e shtetit. Anëtarët e partive politike zënë postet politike në shtet. Në përgjithësi, duke u fokusuar në partitë politike dhe sistemet partiake duhet të theksuar se ato determinojnë konsolidimin demokratik dhe cilësinë e atij sistemi. Pra partitë politike ndikojnë në tri sfera: në raportet parti politike-shtet, raportet ndërpartiake pra arritjen e koalicioneve ndërpartiake ku shfaqja e praktikave jo demokratike zhduket dhe raporti parti politike-shoqëri ku partitë janë ato që në një mënyrë e vetëdijesojnë masën për rregullat demokratike.

Konsolidimi varët në masë të madhe nga partitë pasi që ato kanë një rol të rëndësishëm në shtet ku në demokracitë liberale konsiderohet se ato e okupojnë shtetin, rregullojnë aspekte të rëndësishme shtetërore si ushtria, administrata publike etj. Në këtë mënyrë konsiderohet se partitë janë një aktor i rëndësishëm i cili legjitimon sistemin politik. Roli i partive në shoqëri e cila është në udhën e demokratizimit është vital, pasi që ato rregullojnë lidhjet shtet-shoqëri, janë promovuese të kontratës sociale nën mbështetjen demokratike, integrojnë grupe të ndryshme shoqërore në sistem, rrënjosin një ndër vlerat themelore të demokracive liberale pra participimin në garat elektorale. Megjithatë lidhjet ndërpartiake kanë rëndësi të jashtëzakonshme në konsolidimin e demokracisë pasi që me koalicione të ndryshme dhe me kompetencën e ligjshme shmangen konflikte të ndryshme të cilat mund të degradojnë nivelin demokratik ose në raste të ndryshme ta ndryshojnë krejt regjimin.

¹³ Rustow, Dankward, *Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model*, Columbia University Press, 1970, Fq 358

¹⁴ Pirdham, Geoffrey, *Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe*, Routledge Sigurimi i Demokracisë Partitë Politike dhe Konsolidimin Demokratik në Evropën Jugore), New York, 2003, Fq 57

Bibliografia

Bingham Powell, Contemporary Democracies: Participation, Stability and Violence (Demokraci Bashkëkohore: Stabilitet dhe Dhunë), Cambridge, Mass., Harvard University Press, 1982

Hague Rod and Harrop Martin, Comperative Government and Politics(Krahasim Qeveritar dhe Politik), 6thEdition, Basingstoke, Macmillan, 1987

Linz Juan and Alfred Stepan, DemocraticTtransitions and Democratik Consolidation: Southern Europe, South America, and Post-Communist Europe (Tranzicionet Demokratike dhe Konsolidimi Demokratik:Europen Jugore, Ameriken Jugore dhe Shtetet Post-Komuniste), Mimeo, 1991

Morlino Leonardo, Democratic Consolidation (Konsolidimi Demokratik), Oxford University Press, 1998

Pirdham Geoffrey, Securing Democracy Political Parties and Democratic Consolidation in Southern Europe, Routledge Sigurimi i Demokracisë Partitë Politike dhe Konsolidimin Demokratik në Evropën Jugore)New York, 2003

Rustow, Dankward , Transitions to Democracy Towards a Dynamic Model (Tranzicionet Demokratike Drejte një Modeli Dynamik), Columbia University Press, 1970

Whitehead, Laurence, The Consolidation of Fragile Democracies (Konsolidimi i Demokracive të Brishta), European Consortium for Political Research (ECPR), 1988